

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVAO/REPUBLIC OF KOSOVO

Nr.regj.37299/11

REPUBLIC OF KOSOVO Ministry of Justice Department of Legal Affairs	
Dep. 02	03-3556/12
02	05.10.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqtar Muart Paçarada dhe sek.juridike Naim Thaqin duke vendosur sipas udhëzimeve të Aktvendimit nr.823/12 të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje në procedurën kundervajtëse kundër të pandehurit Driart Halit Elshani, për kundervajtje nga neni 7 paragrafi 1.1 sanksionuar me nenn 16 parag.1.2, të Ligjit për Deklarimin, Prejardhejen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik (Ligji me nr.04/L-050) e në bazë të nenit 73, 74, 195, 199, nenit 198. al. 1. pika 8, dhe nenit 227 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.28.09.2012 bjen këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET, procedura kundervajtëse ndaj të pandehurit Driart Halit Elshani i lindur me 14.06.1979 në Prishtinë, ku edhe jeton, Rr" Bledit".nr.6/A, i pa martuar, fakultetin e kryer, Drejtor i Departamentit për Qeverisje Elektronike, pranë Ministrisë së Administratës Publike, për kundervajtje neni 7 paragrafi 1, i sanksionuar me nenin 16 paragrafi 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhejn, Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e konform nenit 198 al.1 pika 8, për shkak se konsiderohet se nuk ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka krye kundervajtjen.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkeses.

A R S Y E T I M

Agjencioni Kundër Korrupsion, me kërkesën nr.01-4101/11 të parshtruar gjykatës me dt.26.10.2011 për fillimin e procedurës kundervajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundervajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkeses së parashtruar gjyqtari zhvilloj procedurën kundervajtëse kundër të pandehurit Driart Elshanit, dhe me dt.24.02.2012, me aktvendimin me nr.regj:37299/11 e shpalli fajtor dhe e dënoj me gjobë prej 500(pesqind)euro, për shkak se me rastin e marrjes së detyrës nuk e ka bërë deklarin e pasurisë.

I pandehuri në afatin ligjor e atakoj me ankësë aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundervajtje në Prishtinë. Gjykata e Lartë e Aprovej ankesën e të pandehurit, e Abrogoj aktvendimin, dhe lënden ja ktheu Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe e obligoj që të ndermarr edhe disa veprime procedurale që edhe ma bindëshem të zbardhet e verteta rreth kësaj vepre kundervajtëse.

Gjyqtari duke veprue sipas sugjerimeve të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje, thirri seancën e ballafaqimit në mes të të pandehurit Driart Elshanit dhe Zyrtarës kontaktuese me Agjencionin Kundër Korrupsionit Bahtije Spancën. Në këtë seancë deshmëtarja theksoj në praninë e të pandehurit: "Drejtor, un kam ardh në zyrën e juaj, ja u kam urue detyrën, si dhe ja u kam dorzue formularët, dhe katalogun e dhuratave, si dhe ju kam njohtuar se se jeni të obliguar ta beni deklarin e pasurisë". I pandehuri në këtë seancë i kundërshtoj thenjet e të pandehurës.

Gjykatësi nga kjo seancë fitoj bindjen e lirë se i pandehuri është njohtuar me kohë dhe e dënoj prap me denimin prej 500(pesqind)euro. me aktvendimin 37299/11 datë:21.06.2012.

I pandehuri prap e atakoj këtë Aktvendim, ku Gjykata e Lartë për Kundervajtje prap e Abrogoj këtë akvendim, me theks të veçant, se mungon lista mbi pranimin e dokumentacionit, i nënshkruar nga i pandehuri. Gjyqtari i kësaj çështje kundervajtëse, duke vepruar sipas këtyre udhëzimeve e thirri përfaqësuesin e ushtruesit të kërkesës Agron Behramin i cili në deklaratën e tij të dhënë me datën 20.09.2012 theksoj: Ne nga zyrtarja e personelit jemi njohtuar pas dy muajve që Driart Elshani është zgjedhur në detyrën e Drejtorit, pra nuk na njohtuar me kohë edhe pse e ka psur për obligim që në afatin prej 15.ditësh të na njohtoj lidhur me zyrtarin e emruar, si dhe me shkrim ka pasur obligim që ta njohtoj zyrtarin të cilin ajo nuk e ka bërë.

Gjyqtari pas deklaratës së ushtruesit të kërkesës, fitoj bindjen e lirë se nuk ka prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka kryer kundervajtjen me të cilën ngarkohet, andaj konform nenit 198 al.1 pika 8 të LMK-së e **PEZULLOJ**, procedurën lidhur me këtë çështje juridike.

2.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kunder këtij aktvendimi ankesë mund të ushtrohet Gjykates së Lartë për Kundervajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.Regj:37299/11,Prishtinë,28.09.2012

Gj y q t a r i
Murat Paçarada